



VENDIM

Nr. 81 Datë 12.09.2011

**PËR
SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË "KALIVAC GREEN
ENERGY" SH.P.K PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES
(HEC I KALIVACIT), SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 39 të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 "*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*", të ndryshuar, neneve 9 pikat 1 dhe 2 gërma "a" të Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.9, datë 21.02.2007, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.09.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Kalivac Green Energy" sh.p.k, për kualifikimin e impiantit prodhues të HEC "Kalivaçi", si burim i rinovueshëm energjie, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatohet se:

Aplikimi i shoqërisë "Kalivac Green Energy" sh.p.k, plotëson kërkesat e përcaktuara në Rregullat e Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme, të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 9, datë 21.02.2007 si më poshtë:

- **Neni 7, pika 1, gërmat "a", "b", "c", "d"**
Është plotësuar tërësisht
- **Neni 7, pika 2, gërma "a", "b", "c", "d"**
Është plotësuar tërësisht
- **Neni 7, pika 4, gërma "a", "b", "c"**
Është plotësuar tërësisht

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Kualifikimin e impiantit prodhues (HEC i Kalivacit) si burim i rinovueshëm energjie.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol RAMADANI